

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti për Çështje Ekonomike, me gjykatësin Faton Bajrami, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësit KS “K. e R.”, me seli në P., të cilën e përfaqëson sipas autorizimit K.E., kundër të paditurës NTP “E.”, me seli në K., të cilën e përfaqëson sipas autorizimit B.K., avokat nga P., objekt i kontestit – rimbursim i mjeteve, pas përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor nga, me datën 24.10.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET, si e pabazuar kërkesëpadia e KS “K. e R.”, me seli në P., që të detyrohet pala e paditur NTP “E.”, me seli në K., që në emër të Marrëveshjes jashtë Gjyqësore për sigurimin e tenderit t’ia paguajë shumën prej 10.507.35€, në emër të rimbursimit, me kamatë 12% në vit, duke llogaritur nga dita e pagesës, e deri në pagesën përfundimtare, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, pasi që kërkesa nga kjo padi është parashkruar.

II. Detyrohet paditësi që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, t’ia paguaj palës së paditur shumën prej 239.00€.

A r s y e t i m

Paditësi KS “K. e R.”, me seli në P., me padinë e paraqitur me datën 28.07.2017 kërkon nga gjykata që ta detyroj palën e paditur NTP “E.”, me seli në K. që në emër të marrëveshjes jashtë gjyqësore për sigurimin e tenderit, me nr.5/12, t’ia rimburoj shumën prej 10.507.35€, me kamatë ligjore. Më tej në padi theksohet se për shkak të dështimit në përmbushjen e detyrimeve kontaktuese “Lot 1- Asfaltimit të rrugësve lokale nga e paditura NTP “E.”, me datën 09.12.2012, ka pranuar kërkesën nga Komuna e V., e cila e kishte konfiskuar Garancionin, sipas policës me nr. 57875/2011, e lëshuar në emër të kontaktuesit N.T.P “E.”. Me shkresën e autoritetit kontraktues është kërkuar realizimi i transferimit të mjeteve në shumën prej 10.507.35€, në emër të Garancionit të ekzekutimit të kualitetit të punimeve të datës 05.12.2011, për Komunën e V.. Paditësi pas shqyrtimit të dokumentacionit të parashtruar, si dhe Deklaratës së Garantuesit – siguria e kualitetit të punimeve me nr. 57875/2011, datë 05.12.2011, e ka pranuar dëmin dhe për të njëjtën ka bërë pagesën në shumën prej 10.507.35€, në emër të Komunës së V.. Ky edhe ishte qëllimi i lidhjes së marrëveshjes së lidhur jashtëgjyqësore në mes të paditësit dhe të paditurit për Sigurimin e Tenderit.

I padituri, në përgjigjen e saj në padi ka theksuar se e kontestojnë në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë, nga fakti se nga lëshimi i Urdhëresës për Transfer me datë 05.04.2013, e

gjer ke parashtrimi i padisë kanë kaluar 4 vite 7 muaj e 7 ditë, andaj në bazë të këtyre kërkesa e paditësit është e parashkruar. Në bazë të cekurave të më sipërme i ka propozuar gjykatës që pas shqyrtimit gjyqësor, padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve ta refuzoj si të pabazuar. Në seancën përgaditore të mbajtur me datë 24.10.2018, përfaqësuesi i palës paditëse deklaroi se mbetet pran padisë dhe kërkesëpadisë, kërkon nga gjykata që ta detyroj palën e paditur ‘E.’, me seli në K., që palës paditëse t’ia paguaj shumën prej 10.507.35€, në emër të rimbursimit nga sigurimi i tenderit me kamat prej 12%.

Ndërsa sa i përket deklarimeve nga përgjigjia në padi se kërkesat janë parashkruar e kundërshtojnë sepse kërkesat nga sigurimi parashkruhen për 5 vite, kështu që nga shkresat e lëndës rezultoi se marrëveshja e arritur në mes palëve ndërgjyqëse është bërë me datë 21.12.2012, derisa padia është ushtruar në gjykatë me datë 28.07.2017, andaj me pohimin e borxhit afati i parashkrimit afati i parashkrimit ka filluar të rrjedh nga kjo datë. Në këtë seancë përfaqësuesi i palës së paditur deklaroi se mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi, i propozon gjykatës që ta refuzoj padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit nga se e njëjta është e parashkruar, duke shtuar se i kërkojnë edhe shpenzimet e procedurës.

Gjendja faktike e vërtetuar

Për ta vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejt gjendjen faktike gjykata administroi këto prova: polisa për sigurimin e garancisë së tenderit dhe ekzekutimit të kontratës nr.57875 datës 12.05.2011, parashkresa e lëshuar nga komuna e Vushtrrisë datës 22.10.2012, marrëveshja jashtë gjyqësore nr.5/12 datë 26.12.2012, urdhër transferi i datës 05.04.2013, marrëveshja jashtë gjyqësore e datës 21.12.2012, aktgjykimi IV.C.nr.361/17 datës 05.06.2018.

Përfaqësuesi i të paditurës në fjalën përfundimtare kishte deklaruar se kërkesa e paditësit është parashkruar konform dispozitës ligjore.

Pas administrimit të provave dhe vlerësimit me kujdes të tyre, secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, konform nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike:

Me dispozitën e nenit 362 të Ligjit për Marrëdhënie të Detyrimeve (LMD-së), 1. Kërkesat e kontraktuesëve të sigurimit, respektivisht personit të tretë nga kontrata e sigurimit të jetës, parashkruhen për pesë (5) vite, kurse nga kontratat tjera për sigurimin për tri (3) vite, duke llogaritur nga dita e parë pas kalimit të vitit kalendarik në të cilën është krijuar kërkesa.

Gjykata e ka shqyrtuar deklarin e të paditurës lidhur me parashkrimin e borxhit dhe duke pasur parasysh se paditësi ka ushtruar padi me datën 28.07.2017 për rimbursimin e borxhit nga sigurimi i tenderit, ndërsa urdhri për transfer është bërë me datën 05.04.2013. Kur dihet parasysh se parashkrimi për këtë lloj kategorie të detyrimeve fillon nga viti vijues, gjegjësisht si në rastin konkret që ka filluar të rrjedh me 01 janar 2014, kanë kaluar më shumë se tri (3) vite, gjykata ka ardhur në përfundim se borxhi i të paditurit ndaj paditësit, është parashkruar.

Duke u bazuar në faktet dhe rrethanat e lartcekura dhe në dispozitat ligjore të cituara më sipër, gjykata e refuzoi kërkesëpadinë e paditësit.

Gjykata duke vendosur mbi shpenzimet kontestimore në nenin 449 të LPK-së, është përcaktuar përbërja e shpenzimeve procedurale dhe në bazë të Tarifës së Odës së Avokatëve konstatoi si në vijim: për përpilimin e përgjigjes në padi shumën prej 104,00 , si dhe ne emër te përfaqësimit per nje seance shumen prej 135,00 €.

Në këtë çështje kontestimore, pala e paditur i ka kërkuar kompensimin e shpenzimeve kontestimore. Më nenin 452.1 të LPK-së është përcaktuar se “pala e cila e humb procesin gjyqësor tërësisht ka për detyrë që palës kundërshtarë gjyqfituese, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, t’ia shpërblej të gjitha shpenzimet gjyqësore”.

Nga sa u tha me larte u vendos si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE PRISHTINE
Departamenti për Çështje Ekonomike
V.EK.nr.362/2017, datë 24.10.2018

G j y k a t e s i,
Faton Bajrami

KËSHILLË JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejt ankese, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, në afatin prej 7 ditësh nga dita e pranimit të tij.